

# THIRRJE PËR APLIKIM PËR BIOLOG-EMBRIOLOG KLINIK NË QENDRËN E RIPRODHIMIT MJEKËSOR TË ASISTUAR NË S.U.O.GJ. "KOÇO GLIOZHENI"

Bazuar në kreun III, pika 4 të Statutit "Për procedurat e marrjes në punë në S.U.O.GJ. "Koço Gliozheni" dhe në Vendimin e Bordit të spitalit Nr. 4 dt. 16.12 2022 "Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në Strukturën Organizative të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni" si dhe urdhërit të brendshëm të drejtorit të Spitalit nr. Prot.744 dt. 31.7.2023 mbi përcaktimin e kriterëve, shqyrtimin e dosjeve dhe intervistës së konkurrentëve për pozicionin e punës, shpallet thirrja për aplikim për pozicionin e lirë të punës Biolog-Embriolog Klinik në Qendrën e Riprodhimit Mjekësor të Asistuar, në S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni".

**Dorëzimi i dokumentave bëhet nga datat 2-28 Gusht 2023**

**pranë zyrës së arkivë-protokollit të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni",**

**në adresën Blv. "Bajram Curri" 9 (sipër Brrylit), Tiranë (ora 9.00-16.00)**

## **Përshkrimi i detyrave dhe karakteristikave të punës:**

- a) Përgatit terrenet e kultivimit të embrioneve;
- b) Kalibron pajisjet e laboratorit *in vitro*;
- c) Ekzaminon, pastron dhe përzgjedh ovocitet pas procesit të marrjes së tyre;
- d) Administron dhe përgatit vezët për fertilizim dhe/ose për ngrirje;
- e) Kryen bashkimin e vezëve me spermatozoidet nëpërmjet metodës klasike të *FIV* ose me metodën *ICSI*;
- f) Kontrollon dhe menaxhon procesin e fertilizimit të vezëve dhe zhvillimin e embrioneve;
- g) Kryen biopsinë embrionale për *PGT (preimplantation genetic testing)*;
- h) Përzgjedh embrionet më të mira për t'i transferuar në uterus;
- i) Kryen procedurat e ngrirjes dhe shkrires së ovociteve, spermatozoideve dhe embrioneve;
- j) Realizon analizën e spermogramës dhe përgatitjen e spermës për *IIU* ose *FIV*;
- k) Mban dhe menaxhon dokumentacionin e laboratorit të fekondimit *in vitro*;
- l) Katalogon dhe menaxhon të dhënat e pacientëve të ruajtur në bankën e gametave dhe embrioneve;
- m) Koordinon veprimtarinë e laboratorit me atë të mjekëve gjinekologë;
- n) Informon pacientët dhe i mjekët përkatës për ecurinë laboratorike të embrioneve.
- o) Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga drejtuesi i Qendrës së Riprodhimit Mjekësor të Asistuar, që ka lidhje me proceset me të cilat lidhet profili i punës.

## **Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret si vijon:**

### **Kritere të përgjithshme:**

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrat;
- c) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale;
- d) Të mos ketë masa disiplinore, që nuk u janë shuar efektet;

### **Kritere të posaçme:**

- a) Të ketë kryer arsimin e lartë, profili Biolog;
- b) Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Biologji Molekulare apo të njëjtë me të (*Specializimet që kanë të bëjnë/kanë lidhje me riprodhimin mjekësor të asistuar përbëjnë avantazh*);

- c) Preferohet të ketë minimumi 3 (tre) vjet eksperiencë pune, në profesion (*pozicione pune, që i përngjajnë profilit të punës përbëjnë avantazh*);
- d) Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze ose një nga gjuhët e Komunitetit Europian e vërtetuar me certifikatë;
- e) Të përmbushë në kohë dhe me korrektësi detyrat e ngarkuara në rregulloren e brendshme të institucionit si dhe kërkesat e titullarit të institucionit;
- f) Të zotërojë njohuritë dhe eksperiencën e duhur në fushën e riprodhimit mjekësor të asistuar;
- g) Të ketë njohuri të përdorimit të programeve kompjuterike bazë, aftësi në fushën e teknologjisë së informacionit dhe menaxhimit të të dhënave laboratorike;
- h) Të ketë aftësi të mira komunikimi, aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin dhe përdorimin e metodave dhe procedurave të reja në fushën e riprodhimit mjekësor të asistuar, aftësi shumë të mira të punës në grup dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të punës.

### **Dokumentacioni i kërkuar:**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së arkivë-protokollit të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni", Tiranë dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë me shkrim/Letër motivimi;
- b) Jetëshkrim (CV) të përditësuar, (*ku të përfshihen të dhënat e kontaktit – numër telefoni/e-mail*);
- c) Diplomat e shkollës së lartë, lista e notave /fotokopje të njehsuara me origjinalin. (*Diplomat dhe dokumentacioni që vërteton arsimimin akademik, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi*);
- d) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqete saj, që vërtetojnë eksperiencën në punë)/vërtetim të periudhave të punësimit nga sigurimet shoqërore;
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (*ID-së*);
- f) Raport mjekësor për aftësinë në punë/vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Dëshmi penaliteti;
- h) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe të kualifikimeve, specializimeve, arsimimin shtesë, trajnimet, vlerësimet dhe referencat e mundshme, si dhe ato, që vërtetojnë faktet e tjera të përmendura nga aplikanti në jetëshkrim.

*Dokumentet mund të jenë origjinale (me përjashtim të kërkesave specifike të listuara më sipër në pikën 3), apo të njehsuara me origjinalin.*

*Dokumentet e përftuara në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të njehsuara sipas ligjit.*

Aplikimi dhe dokumentacioni përkatës dorëzohen/dërgohen në Zyrën e Arkivë-Protokollit të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni", në adresën Blv. "Bajram Curri" 9 (*sipër Brrylit*), Tiranë brenda datës 28.8.2023 (*ora 16.00*).

Aplikantët që plotësojnë kriteret, nëpërmjet aplikimit dhe dokumentacionit përkatës, njoftohen individualisht për vendin, datën dhe orën e zhvillimit të intervistës me gojë nga Sektori i Burimeve Njerëzore të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni" në kontaktet e përcaktuara nga aplikantët në CV-të përkatëse.

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar, lidhur me kriteret, përvojën dhe kualifikimin e lidhura me fushën e pozicionit të lirë të punës, si dhe gjatë intervistës me gojë lidhur me njohuritë mbi fushën, aftësitë, eksperiencën e mëparshme, kompetencën, motivimin dhe pritshmëritë në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.

Totali i pikëve është 40 dhe do të kryhet sipas tabelës së Shtojcës 1 të Vendimit të Bordit të spitalit Nr. 4 dt 16.12 2022 "Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në Strukturën Organizative të S.U.O.Gj. 'Koço Gliozheni' (*bashkëlidhur njoftimit*).

**Dalja e rezultateve të konkurimit dhe komunikimi i tyre**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, S.U.O.Gj. 'Koço Gliozheni' do të shpallë fituesin në faqen e vet zyrtare. Fituesi do të njoftohet edhe nëpërmjet kontakteve të shënuara në aplikimin e paraqitur nga ana e këtij të fundit.